



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.577/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Naim Mcholli, në çështjen juridike të paditëses:

nga Mitrovica kundër të paditurit: Spitali Rajonal:
të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim, baza e kontestit: kompenzim i pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, në seancën e datës: 29.02.2015 konform nenit 148 të LPK së bjen këtë:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

1. **APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e Bazuar dhe
2. **OBLIGOHET** e paditura Spitali Rajonal "Dr. ... në Mitrovicë që në emër të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe një për shpërblimi jubilar për katërdhjet vjetorin e punës t'ia paguaj paditëses shumë prej 870 euro në llogarinë nr. ... Prishtina brenda afatit 15 ditor nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm
3. **OBLIGOHET** e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditëses shumë prej 20 euro në emër të taksës për paditë ndërsa gjykatës në emër të taksës për vendim po ashtu shumë prej 20 euro të gjitha këto brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësja me datë: 13.10..2015 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurës për pagës te dy pagave për shpërblim jubilar dhe dy paga përcjellëse.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 29.02.2016. Në këtë seancë pala paditëse deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe ka precizuar kërkesëpadinë ku ka kërkuar 3 paga me qe një page i është paguar sipas kërkesës tek e paditura, andaj kërkoj shumën totale prej 870 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë deklaroi se me rastin e pensionimit paditëses i është paguar një pagë e ashtuquajtur pagë përcjellëse në shumë prej 290 euro mbështetur në koeficientin e pagës të infermieres së përgjithshme. Kërkesën e paditëses nuk e kontestojmë për tri paga edhe atë dy paga përcjellëse për pensionim dhe një pagë jubilarë ashtu siç ishte e përcaktuar me marrëveshje kolektive


Meqenëse kërkesëpadia e paditëses nuk u kundërshtua në aspektin e bazës nga ana e përfaqësuesit të të paditurës, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm mori aktgjykim në bazë të pohimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, dhe pa shqyrtim të mëtejshëm në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,
C.nr. 577/2015 Me dt. 29.02.2016.

GJYQTARI,
Naim Mehulli



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat 15 ditor nga dita e pranimin të të njëjtit, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate,